



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat për procedurat e miratimit të kontratave të huamarrjes shtetërore.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura për çështjen “CEZ-Shpërndarje sh.a””.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj

Mungon:

Fatmir Mediu, Tom Doshi.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit!

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e kërkesës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat për procedurat e miratimit të kontratave të huamarrjes shtetërore (kërkohej një opinion).

Zonja Hysi së bashku me këshilltarët kanë përgatitur një opinion në reagim të kërkesës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat lidhur me procedurat e miratimit të kontratave të huamarrjes shtetërore.

Ka nevojë për një prezantim apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull. Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse thatë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka dërguar një shkresë, ku kërkon mendim për procedurat e miratimit të kontratave të huamarrjes shtetërore, me argumentin se nuk është e qartë nëse janë përdorur standarde të dyfishta lidhur me ratifikimin e marrëveshjes së huamarrjes shtetërore apo të financimit në formën e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive apo institucioneve financiare ndërkombëtare.

Shtrohen dy pyetje nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat: a duhet që Kuvendi të ratifikojë të gjitha marrëveshjet edhe nëse ato janë në përputhje me linjat e buxhetit, pra nuk tejkalojnë kufizimet e ligjit për buxhetin vjetor?

Së dyti, a duhet të kalojnë ose jo në parlament marrëveshjet e grantit me donatorë të ndryshëm? Në fakt, një shqetësim i tillë ka lindur edhe në komisionin tonë, ku zoti Fino shpeshherë gjatë diskutimit të granteve ose të marrëveshjeve të ndryshme e ka kërkuar një gjë të tillë.

Për t'u dhënë përgjigje të dyja pyetjeve që ka shtruar Komisioni për Ekonominë dhe Financat do të kemi parasysh Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Për sa i përket pyetjes së parë që shtron Komisioni për Ekonominë dhe Financat: “A duhet të miratohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kontratat e huamarrjes shtetërore në rastet kur ato respektojnë kushtet e përcaktuara në ligjin “Për buxhetin vjetor”?”, dua të sjell në

vëmendjen tuaj pikërisht germën “ç” të nenit 121 të Kushtetutës së Shqipërisë: “Kuvendi i Shqipërisë ratifikon marrëveshjet për marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë”. Gjithashtu në nenin 156 të Kushtetutës lejohet që shteti të marrë dhe të garantojë hua dhe kredi financiare kur autorizohet nga ligji.

Prandaj, për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, ne kemi renditur në relacionin që keni përpara, rastet kur parlamenti është i detyruar të ratifikojë marrëveshjet. Janë katër raste kur parlamenti detyrohet të ratifikojë marrëveshjet, midis të cilave janë edhe marrëveshjet për marrjen ose për garantimin e huasë dhe kredisë financiare, të cilat konsiderohen të miratuara edhe me vetë autorizimin që ligji u ka dhënë autoriteteve shtetërore. Por kur ka probleme, të cilat lidhen me marrjen përsipër të detyrimeve, konkretisht në germën “ç” të nenit 121 thuhet detyrimisht se Kuvendi duhet t’i ratifikojë marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura në emër të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, po t’i referohemi nenit 57 të ligjit të posaçëm “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, aty parashikohen dy lloje marrëveshjesh: marrëveshjet për marrje huaje, kredie, grantesh ose për dhënie garancish dhe marrëveshjet ose kontratat e huas, që merren brenda limiteve të përcaktuara në ligjin vjetor të buxhetit.

Këtu ka një rregullim të ndryshëm dhe do të doja, edhe për kolegët deputetë, të qartësoja që në grupin e parë të marrëveshjeve hyjnë të gjitha ato marrëveshje, të cilat bëjnë të mundur marrjen e kredive, të huave ose të dhënies së garancive.

Sipas nenit 57, paragrafit 1 të ligjit “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” Këshilli i Ministrave është i vetmi autoritet, i cili ka të drejtë të marrë hua në nivelin qendror për financimin e projekteve, investimeve nga institucionet.

Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe germën “ç” të nenit 121 të Kushtetutës, ku thuhet: “Ratifikimi, denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë” bëhen me ligj, kur merren përsipër detyrime financiare nga Republika e Shqipërisë, si dhe duke pasur parasysh edhe nenin 17 të ligjit “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” që thotë se ratifikimi, aderimi, miratimi dhe denoncimi i traktateve bëhet me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, atëherë arrijmë në një përfundim të dytë se marrëveshjet duhet detyrimisht të ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë, kur këto marrëveshje marrin përsipër detyrime financiare nga Republika e Shqipërisë.

Për sa i përket grupit të dytë të marrëveshjeve, që parashikohen në nenin 57 të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku hyjnë kontrata, marrëveshje huaje, të cilat merren brenda limiteve të përcaktuara në ligjin buxhetor, si Kushtetuta, ligji “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, sanksionojnë që kjo mund të bëhet edhe nga Këshilli i Ministrave. Pra, jo në çdo rast marrëveshje të tilla, kur janë brenda limitit të buxhetit vjetor, mund të vijnë në Kuvendin e Shqipërisë.

Në këtë kuadër duhet të bëjmë dallimin midis asaj që quhet rezervë ligjore relative dhe absolute. Në lidhje me marrëveshjet, që garantojnë hua dhe kredi financiare, këto do të ratifikohen detyrimisht nga Kuvendi i Shqipërisë. Në rastet e tjera, kur flitet për grante të cilat nuk parashikojnë detyrime, si, për shembull, nga taksat, nga TVSH-ja e gjithçka tjetër, që ne shumë herë i kemi parë në aktmarrëveshje të ndryshme, këto nuk kanë nevojë të vijnë në Kuvendin e Shqipërisë. Por nëse i referohemi nenit 57 të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, duhet të kemi parasysh që ka disa lloj kontratash ose grantesh, të cilat parashikojnë përjashtime ose marrin përsipër detyrime financiare nga Republika e Shqipërisë. Në këtë rast duhet të kemi parasysh që nëse në këto marrëveshje granti parashikohet që do të ketë përjashtime nga taksat ose përjashtime të tjera fiskale në lidhje me transferimin e fondeve financiare, atëherë detyrimisht këto lloj marrëveshjesh granti duhen të ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Pra, meqenëse diskutimi më i madh është bërë gjithmonë për grantet, unë do të desha, të nderuar kolegë, të theksoja tri llojet e marrëveshjeve të grantit, të cilat kanë rregullime të ndryshme dhe që duhet t’i kemi parasysh si ne, ashtu edhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Rasti i parë është një marrëveshje granti, e cila, në përmbajtjen e saj, krijon një detyrim të natyrës financiare. Detyrimisht kjo përbën detyrim kushtetues të ratifikohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Rasti i dytë janë marrëveshjet e grantit që nuk përmbajnë detyrime të natyrës financiare. Në këtë rast Kuvendi nuk është i detyruar t’i ratifikojë, por askush nuk na ndalon që Kuvendi, kur e vlerëson të nevojshme, të mund ta ratifikojë një marrëveshje të tillë ndërkombëtare, pavarësisht se nuk parashikohet në germën “ç” të nenit 121. Këtë e parashikon pika 2 e nenit 121 të Kushtetutës.

Rasti i tretë janë marrëveshjet e grantit që duhet të miratohen nga Kuvendi i Shqipërisë edhe në ato raste kur në përmbajtjen e tyre janë dhënë parashikime për përjashtime fiskale në

transferimin e fondeve ose kur për mallrat e shërbimet që mund të blihen nga fondet e një marrëveshjeje duhet të jenë të përjashtuara nga detyrimet e natyrës fiskale.

Për rrjedhojë, të nderuar kolegë, do të desha të theksoja edhe një herë që këto lloj grantesh janë të detyrueshme të kalojnë në Kuvendin e Shqipërisë edhe për shkak të një rregullimi tjetër që bën neni 155 i Kushtetutës, ku thuhet: “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore: lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i një kategorie të caktuar të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre përcaktohet në ligj. Në këtë rast ligji nuk mund të ketë fuqi prapavepruese”.

Në përfundim, sa më sipër vlerësohet që, së pari, marrëveshjet e huasë, kreditë financiare ose të dhënies së garancive shtetërore, të nënshkruara nga Këshilli i Ministrave duhet të ratifikohen nga Kuvendi, si një detyrim i parashikuar nga neni 121 i Kushtetutës, neni 17 i ligjit “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe neni 57 i ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Së dyti, kontratat për marrje huash ose kredish nga persona juridikë ose banka, të cilat janë nënshkruar me një autorizim ligjor nga ministri i Financave dhe që janë brenda limiteve të përcaktuara në ligjin buxhetor vjetor, nuk kanë asnjë detyrim kushtetues që të ratifikohen nga Kuvendi.

E treta, marrëveshjet e grantit, të cilat në përmbajtjen e tyre krijojnë një detyrim të natyrës financiare, të parashikuar në nenin 121 të Kushtetutës, si dhe në rastin kur përmbajnë parashikime për përjashtime fiskale duhet të ratifikohen nga Kuvendi i Shqipërisë, pasi ky është një detyrim kushtetues.

Besoj se me këtë mendim si Komisioni i Ligjeve, ashtu edhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat i japin zgjidhje shqetësimit që ka ngritur shpesh kolegu Fino, por edhe shqetësimit që ngre Komisioni përkatës për Ekonominë dhe Financat.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje ose koment? Jemi dakord me këtë?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Kërkesa që vjen nga Komisioni për Ekonominë për mua është atipike, sepse kërkohet që Komisioni i Ligjeve, pa pasur një rast konkret, pa pasur një çështje konkrete, të shprehet dhe të interpretojë nenet 121, 155 dhe 156 të Kushtetutës, siç parafolësja bëri, duke

arsyetuar se çfarë kuptohet në njërin rast, çfarë kuptohet në nenin 121 me “marrëveshje”, çfarë kuptohet me “grant”, çfarë kuptohet me “detyrime” e me radhë.

Kjo kërkesë është atipike, ndaj edhe relacioni është po ashtu atipik dhe i papërshtatshëm për faktin se Kushtetuta e Shqipërisë nuk na jep neve, si Komision Ligjesh, attribute për të interpretuar asnjë nen të saj, as nenin 1, as nenin 121 dhe as nenin 155. Këtë atribut Kushtetuta ia ka lënë Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 124 të saj. Nëse ka Komisioni i Ligjeve, Komisioni për Ekonominë, parlamenti dhe çdo subjekt tjetër, që parashikohet në nenin 131 të Kushtetutës apo të ligjit material të Gjykatës Kushtetuese, probleme me interpretimin, ai duhet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Logjika mund të jetë e tillë ndërmjet juristëve, debati mund të jetë i tillë: ka qenë produktiv ose jo; ka qenë, sipas rasteve, kur janë trajtuar këtu e dhjetë vjet sa mbaj mend unë, por një interpretim përfundimtar të kësaj çështjeje, një zgjidhje përfundimtare të kësaj çështjeje nuk mund ta japim dot ne, sepse nuk mund të marrim attribute, të cilat Kushtetuta nuk na i ka dhënë.

Në qoftë se do të kishim një rast të caktuar apo një marrëveshje, e cila do të kalonte për mendim konkret, atëherë sigurisht komisioni mund të shprehej, por e thashë, kërkesa për interpretim, në mënyrë të përgjithshme, pra për të gjitha rastet, për të unifikuar, siç i kërkohet këtij komisioni, është atipike, e papërshtatshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën.

Për këtë arsye, opinionimi im është që duhet t’i kthehet përgjigje Komisionit të Ekonomisë, duke u shprehur nga këshilltarët se cila është rruga që duhet të ndjekë Komisioni i Ekonomisë apo çdo komision tjetër brenda parlamentit, apo qoftë edhe parlamenti në rast se kanë probleme me interpretimin e Kushtetutës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje ose komente të tjera? Nuk ka.

Unë mendoj se nuk jemi në rastin e interpretimit të normës kushtetuese, por në rastin e shqyrtimit, të dhënies së një mendimi për Komisionin e Ekonomisë lidhur me procedurat e miratimit të këtyre kontratave, pra me procedurën parlamentare, me sjelljen parlamentare dhe se cili është qëndrimi i Komisionit të Ligjeve. Nëse përputhen të dyja komisionet, kjo do të ishte gjë pozitive. Nëse nuk përputhen dhe një palë e tretë ka nevojë që ta shqyrtojë, qoftë edhe brenda kuorumit parlamentar, për ta bërë këtë një çështje kushtetuese, është në të drejtën e saj. Atëherë,

mbi bazën e një indicieje konkrete do të vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese, sipas ligjit që rregullon funksionimin e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese dhe do të shprehet kjo gjykatë.

Ky ka qenë një diskutim që e kemi bërë brenda nesh për të mbajtur një qëndrim. Ky është qëndrimi që ne mendojmë të mbajmë dhe në qoftë se ky qëndrim do të përputhet në vijimësi me grupet e interesuara, me institucionet e interesuara, kjo do të jetë pozitive dhe nuk do të ketë nevojë për interpretim kushtetues. Në qoftë se ky qëndrim nuk përputhet, palët përkatëse do ta bëjnë çështje gjykimi për interpretim në Gjykatën Kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni!

Eduard Halimi – Kur thashë është atipike, e thashë atipike, sepse nuk ka asnjë nen të Rregullores të cituar, as nga Komisioni i Ekonomisë, që na drejtohet neve, por duhet parashikuar në Rregullore që në bazë të këtij neni duhet t’i kërkohet mendim Komisionit të Ligjeve.

E dyta, nuk ka as edhe një bazë ligjore që Komisioni i Ligjeve të marrë attribute për të unifikuar praktikën parlamentare. Nuk e kemi. Ku ta di unë, mund ta ketë Këshilli për Legjislacionin për të unifikuar ndonjë proces; mund ta ketë. Pra, jemi në një situatë *sui generis* të panevojshme, të papërshtatshme dhe të pambështetur në Rregullore. Në qoftë se ka, hajdeni e marrim dhe e shohim. Në qoftë se duhet ndryshuar Rregullorja, hajdeni ta marrim. Nuk dua të bëj debat, se nuk është ndonjë çështje, në fakt, për të bërë debat politik.

Fatmir Xhafaj – E qartë.

Eduard Halimi – E kam tërësisht teknike, sepse kemi pasur, e thashë, dhjetë vjet këtu ku një herë e kemi ngritur ne, një herë tjetër e ka ngritur tjetri e me radhë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, në fillim të relacionit, që në fjalinë e parë, është përmendur neni 38, pika 5 e Rregullores së Kuvendit, ku thuhet: “Në rast se komisioni përgjegjës miraton në parim projektligjin, ai fillon shqyrtimin dhe votimin nen për nen të tij dhe për çështjet që propozohen për t’i kërkuar mendim Këshillit për Legjislacionin ose komisioneve të tjera...”.

Ata kanë një marrëveshje në shqyrtim dhe është diskutimi që ne shumë herë e kemi bërë edhe në komisionin tonë. Personalisht, në çdo rast që ka pasur marrëveshje nuk e harroj diskutimin e kolegut Fino, i cili ka marrë fjalën dhe e ka përmendur që...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Pse nuk e sqarojmë ne që të mbajmë një qëndrim të unifikuar? Dhe këtë të drejtë na e jep Rregullorja e Kuvendit.

Eduard Halimi – Për ta mbyllur diskutimin dhe kundërshtimin tim, edhe unë e thashë që në fillim se është atipike, sepse do të ishte tipike në qoftë se ne do të shpreheshim për një marrëveshje konkrete. Pra, ata kanë një marrëveshje konkrete, na drejtohen neve për mendim dhe ne japim mendim për një marrëveshje konkrete. E thashë këtu, kjo është një procedurë normale që e parashikon Rregullorja. Ndërsa procedura që na kërkohet që “ju shprehuni për të gjitha rastet se si do të duhet të ndodhë dhe sesi do ta disiplinojmë ne të gjithë punën”, kjo është atipike.

Vasilika Hysi – Ata kanë kërkuar...

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ta sqaroj.

Zoti Halimi, Komisioni i Ekonomisë ka shtruar dy pyetje për grantet. Me sa duket, kanë në dorë një marrëveshje granti.

Unë e kam zgjeruar më shumë për ta sqaruar, sepse këtë shqetësim e ka ngritur disa herë kolegu Fino me shumë të drejtë. Ne kemi qenë ai komision që jemi marrë edhe me shuma të vogla grantesh, të cilat ministri i Financave ka autoritetin e plotë që t'i bëjë, në qoftë se i ka brenda linjave të buxhetit vjetor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ta mbarojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Zoti kryetar, unë besoj se zoti Halimi ishte krejtësisht i qartë. Na kërkohet një mendim unifikues. Sigurisht, materialet kalojnë në këtë komision për dhënie mendimi dhe natyrisht ne shohim edhe këto që thotë zonja Hysi.

Në rastin konkret, nuk na ka kaluar për mendim një grant, një marrëveshje granti apo një marrëveshje për të parë nëse ka ose jo përputhshmëri me ligjet e tjera e me radhë. Na kërkohet, siç tha zoti Halimi, një mendim unifikues se çfarë bëhet në të tilla raste. Por nuk është ky qëllimi ynë, nuk është kjo detyra që kemi. Nuk e shpëton Komisionin e Ekonomisë dhe Financave mendimi ynë pozitiv, që me sa duket ju jeni përgatitur ta thoni sot.

Në qoftë se marrëveshja është konkrete dhe nuk thuhet, me sa duket kanë një marrëveshje të kësaj natyre, vjen këtu dhe relatori do të thoshte: është në respektim të Kushtetutës, është në respekt të ligjit, është kështu, kështu, kështu dhe në qoftë se ka probleme të teknikës legislative, siç ne kemi vepruar gjithmonë, bën sugjerimet e tij. Por ne nuk kemi thënë kurrë që në të tilla raste të veprohet kështu. Në qoftë se marrëveshja apo çështja është konkrete, vjen këtu dhe brenda relacionit të marrëveshjes konkrete ne japim mendimin tonë.

Fatmir Xhafaj – Patjetër, pas interpretimit.

Gent Strazimiri – Nuk mund të japim mendim unifikues.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Në fakt, unë jam dakord në parim, se po flasim për të njëjtën çështje dhe besoj se mund të ketë një keqkuptim. Është thjesht një dhënie mendimi. Ne nuk kemi të drejtë të ndërtojmë procedura unifikuese. Ne nuk kemi të drejtë të interpretojmë nenin kushtetues. Kjo është e padiskutueshme, është atipike, por mendoj se duhet të ketë një korrektësi nga ana jonë.

Ne po japim një mendim, por ndoshta duhet ta nënvizojmë që dhënia e mendimit nga ana jonë nuk është fundore. Ne nuk kemi të drejtë të interpretojmë në mënyrë fundore, sepse në mënyrë fundore në Republikën e Shqipërisë interpreton vetëm Gjykata Kushtetuese.

(Deputeti Strazimiri ndërhyr pa mikrofon.)

Një mendim mund ta japim.

Vasilika Hysi – Dhënie mendimi kemi të drejtë.

(Deputeti Strazimiri ndërhyr pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Megjithëse çështjen e kam ngritur shumë herë, më vjen keq nga diskutimet e kolegëve të mi të djathtë, sepse ky është një diskutim me të vërtetë jo për të harxhuar kaq shumë kohë. E kupton? Vetë kemi thënë që kur janë çështje grantesh, madje edhe grantesh me shuma qesharake, nuk ka pse të rëndohet një parlament me mbledhje komisioni, me vendim komisioni, me seancë plenare, me relacion e të tjera me radhë kur me Kushtetutë çdo ministër ka të drejtë ta firmosë atë.

Po të jetë kredi, po; po të jetë grant minimal, siç kalojnë këtu herë pas here grante, të cilat ju i keni parë, nuk ka asnjë arsye që të merret as komisioni ynë, as Komisioni i Ekonomisë, xhanëm asnjë komision tjetër, as parlamenti.

Unë këtë gjë e kam bindje dhe kur është ndonjë grant konkret këtu të gjithë jemi bashkë kur vjen puna për ta diskutuar. Të gjithë themi: po, kjo është e vërtetë, por hajde ta kalojmë edhe sot, të mbyllim sytë, pse duhet ta rregullojmë patjetër. Ndërsa tani që vjen momenti kur mundemi vërtet ta rregullojmë dhe të themi se ç'janë punë grantesh ne nuk kemi pse t'i kalojmë këtu, sepse ofendojmë edhe veten tonë, të votojmë për 50000-60000 euro grant që japin vende të ndryshme, kupton, tani të themi: jo, tani nuk kemi të drejtë ne. Pse? Sepse ka bërë kërkesë Komisioni i Ekonomisë, por ka të drejtë të vendosë Gjykata Kushtetuese. Këtë sinqerisht nuk arrij ta kuptoj, se këtu nuk ka asgjë... Sinqerisht, këtu nuk ka asgjë politike. Këtu është një gjë totalisht teknike.

Themi: po qe grant, ta firmosin ministrat vetë. "Cilido ministër të jetë", kështu e kam thënë unë, ta firmosë ministri. Ka marrë votëbesimin. Pra, kushdo ministër qoftë. Po qe grant; po qe kredi, po, do të kalojë në parlamentin shqiptar. Çfarë ka këtu për diskutim për të thënë: "Jo, ne këtë javë nuk duam. Tani çojeni në Gjykatën Kushtetuese"? Mua më duket absurd i gjithë diskutimi që bëjnë kolegët e mi të djathtë. Gjithsesi, në qoftë se keni kohën e tepërt, kaloni vëllezër çdolloj granti që vjen këtu, qoftë edhe me 5 euro, qoftë edhe me 10 euro, harxhoheni kohën tuaj të vyer edhe me këto grante, që nuk kanë asnjë vlerë, e kupton! Që duhet t'i firmosë një ministër.

Vendosni ju si komision dhe ne të gjithë harxhojmë kohën e të tjera me radhë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Ristani.

Arben Ristani – Me sa kuptoj unë, zoti Fino kërkon që ne të stabilizojmë një procedurë, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, që ne të stabilizojmë një procedurë, do të thotë që ti si komision të kesh të drejtën të vendosësh norma sjelljeje. Dakord? E kemi ne të drejtën si komision të vendosim norma sjelljeje, të bëjmë ne procedura të përgjithshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është teknikë, mor, nuk ka politikë në këtë mes! Nuk po bëjmë politikë fare. Është komplet teknike. Po na kërkohet të vendosim rregulla sjelljeje për të tjerët.

(Deputeti Peza ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se janë, t'i zbatojmë. Pse na kërkojnë neve që të vendosim një procedurë? E pra, kjo është krejt teknike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Peza! Nuk keni pse bëni replikë. Merreni fjalën, po të keni ndonjë gjë!

Arben Ristani – Ne japim mendim kur vjen problemi i caktuar.

Nëse kemi një problem të caktuar, ne mbledhemi dhe themi: për ne është ose jo në rregull; duhet bërë kështu apo duhet bërë ashtu, por për çështje konkrete.

Në momentin kur ti do të japësh mendim për çështje të përgjithshme, atëherë ti vendos rregulla sjelljeje. Jemi ne kompetentë për të vendosur rregulla sjelljeje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kaq e thjeshtë është historia!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Strazimiri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Peza, do ta merrni fjalën pas zotit Strazimiri.

Gent Strazimiri – Ndoshta ju ndihmoj me këtë.

Ja, cila është kërkesa që na ka nisur Komisioni për Ekonominë dhe Financat:

“I nderuar zoti kryetar,

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve të huamarrjes shtetërore apo të financimit në formën e grantit nëpërmjet Këshillit të Ministrave...” e të tjera, “...në Komisionin për Ekonominë dhe Financat ka lindur vazhdimisht diskutimi lidhur me bazueshmërinë ligjore të kësaj procedure. Ky shqetësim është ngritur nga deputetët, për arsye se është konstatuar që jo të gjitha marrëveshjet vijnë në Kuvend për t’u ratifikuar me ligj. Një pjesë e marrëveshjeve miratohen nga Këshilli i Ministrave apo Ministria e Financave, kurse një pjesë tjetër ratifikohen me ligj.”

Kërkesa është: “Si të veprojmë në të tilla raste që vazhdimisht na dalin para në të?” Kjo është dhënie mendimi dhe unifikim. I thua: “Sillu...”, siç tha zoti Ristani “në këtë mënyrë, me këtë tipologji rastesh”. Nuk është një rast konkret, nuk është një marrëveshje konkrete, së cilës ne i shohim përputhshmërinë me ligjin. Çështja është më se e qartë, e kanë shkruar e zeza mbi të bardhë, ata kërkojnë: “Vazhdimisht kemi këtë problem. Si duhet të sillemi vazhdimisht”?

Në qoftë se ju ndieni se e keni kompetencën për t'u shprehur atyre se si duhet të sillen vazhdimisht me këtë tipologji marrëveshjesh që u vijnë nga qeveria, ju mund të keni mendimin se e keni kompetencën për t'ia dhënë, ne themi jo. Dhe këtu nuk ka asgjë politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Peza, që ta mbyllim këtë diskutim.

Bashkim Fino – Kjo është absurde.

Dashamir Peza – Ajo që mua më shqetëson në përgjithësi, zoti Strazimiri, nuk është mënyra thjesht sesi ka hartuar letrën Komisioni për Ekonominë dhe Financave kur na e ka adresuar neve.

Ne nuk po përpiqemi sot, dhe ky nuk është një diskutim që e ka bërë vetëm zoti Fino, e kam bërë vetëm unë, por e kam dëgjuar pothuajse nga të gjithë kolegët që të gjithë janë të vetëdijshëm se në procedurat që bëhen ka disa grante, të cilat i përcillen parlamentit që nuk janë kërkesë e ligjit për të kërkuar. Ne kemi ndjekur praktikën që thjesht i kemi kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tre herë do të flasësh, po nuk ka problem këtu. Problemi shtrohet: a është edhe më mirë që disa grante të kalojnë me firmën individuale të drejtuesve të dikastereve, të cilët janë të ngarkuar për t'i administruar këto grante, për të qenë edhe më të përgjegjshëm për firmën që hedhin? Ky është shqetësimi im personal dhe për këtë arsye e kam ngritur, sepse duke e ratifikuar në parlament ne e shmangim edhe nga përgjegjësitë e mundshme që mund të kenë nesër këta individë, se thonë: e ka kaluar parlamenti dhe nuk mbaj asnjë përgjegjësi.

Problemi është si, ngarkuar dhe brenda ligjit, të kenë përgjegjësi personale njerëzit që marrin përsipër të nënshkruajnë grante dhe aktivitete? Kjo është e gjithë historia.

Tani, do të merremi me thelbin dhe mënyrën sesi është hartuar letra, apo do të merremi me shqetësimin që është ngritur nga të gjithë deputetët e parlamentit? Kjo është pyetja që shtrohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po nuk ka, një sekondë tani, se nuk...

Gent Strazimiri – Në fakt, e dini...? Se na ndihmoi edhe zoti Peza.

Zoti Peza, mënyra sesi është përpiluar letra...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, më fal! Është krejtësisht korrekte, si çdo letër tjetër: ka kokën, ka datën, numrin e protokollit, lëndën dhe drejtimin.

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Në fund fare, ky thotë: “Veçanërisht është me rëndësi të theksohen rastet kur duhet të ratifikohen marrëveshjet e grantit”.

(Deputeti Peza ndërhyr pa mikrofon.)

Shqetësimi...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Po qe se doni, zoti Peza bashkë me zotin Strazimiri, dilni aty jashtë dhe sqarohuni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gent Strazimiri – Sapo ju thashë, zoti Peza, që nuk shpëton njeri nga përgjegjësia, dhe ky është mendimi ynë këtu, sepse ky thotë: është shkruar e zeza mbi të bardhë dhe kjo nuk është formë, por është përmbajtje, është vetë thelbi.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Gent Strazimiri – Unifikimi i këtij qëndrimi do të na ndihmonte të... A e ndihmon dot? Unë po them që nuk i nxjerr dot jashtë përgjegjësisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Gent Strazimiri – Jepjani këtë atribut vetes dhe bëheni dakord me partishmëri, por ligjore nuk është.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Besoj se debati u konsumua, duke pasur opinione të ndryshme për këtë çështje. Natyrisht, jo aq për thelbin sesa më shumë për formën.

Duhet të sqaroj vetëm dy momente: a mund të iniciohej dhe a mund të vihej në lëvizje komisioni ynë sipas Rregullores? Po. Në pikën 5 të nenit 38 është e qartë se ai si komision ka të drejtën të kërkojë mendim dhe ne kemi detyrimin të përgjigjemi.

Nga pikëpamja procedurale, se si e harton...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse ne do të merrnim përsipër të interpretonim normën kushtetuese, absolutisht, unë jam shumë dakord me të gjithë ata kolegë që thonë se këtë atribut nuk mund ta marrim ne dhe nuk duhet ta bëjmë këtë gjë. Por ai thotë: kemi dy qëndrime në parlament, njëri që e mbajmë ne, një

qëndrim e mbani ju, komisionet e tjera. A mund të jepni një mendim si e keni ju? Ata mund të thonë: mendimi i Komisionit të Ligjeve nuk është ky që duam dhe mbajnë një qëndrim.

Në momentin që do të ketë një problem që të dyja komisionet nuk merren vesh, çështja do të shkojë në Këshillin e Legjislacionit. Nëse pastaj as Këshilli nuk e zgjidh, do të kërkohet interpretim në Gjykatën Kushtetuese. Le ta provojmë fazë-fazë, pra një procedurë parlamentare, në mënyrë që parlamenti të mos ketë dy apo tri procedura, por të ketë një procedurë. Nëse të dyja komisionet nuk bien dakord, i shkohet Këshillit të Legjislacionit dhe vazhdojmë me praktikën e mëtejshme.

Ndërkohë, mendoj që në relacionin e paraqitur nga zonja Hysi t'i jepet hapësirë komentit që bëri zoti Halimi dhe kolegët e tjerë të opozitës, pa dyshim edhe komentit që bëri zoti Fino, që është një qëndrim i kahershëm lidhur me çështje të kësaj natyre, si dhe i shumë kolegëve të tjerë, që e kanë mbështetur atë ide. Kështu që le të mbahet si bazë opinionin e paraqitur nga relatorja, t'i jepen edhe komentet që Komisioni për Ekonominë të dijë të gjykojë që ka edhe disa qëndrime të ndryshme nga ky qëndrim themelor dhe le të vendosë.

Nëse ata bien dakord me këtë zgjidhje, problemi është më i thjeshtë. Nëse ata nuk bien dakord, do të sugjerojmë të shkohet në Këshillin e Legjislacionit dhe pastaj për të ndjekur hapat e mëtejshëm. Por është shumë e rëndësishme që të paraqiten të dyja opinionet. Pastaj mbetet në vlerësimin e komisionit përgjegjës për të ndjekur procedurat e mëtejshme parlamentare.

Ka vërejtje tjetër? Biem dakord me këtë procedurë? Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Në rregull, biem dakord të gjithë dhe ecim me këtë logjikë. Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.11.2015, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura për çështjen “CEZ-Shpërndarje sh.a”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj

Mungon:

Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që është paraqitja e projektligjit, iniciuar nga një grup deputetësh, lidhur me lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura për çështjen “CEZ-Shpërndarje sh.a”.

Një grup deputetësh të parlamentit të Shqipërisë, deputetë të Partisë Demokratike, kanë paraqitur, konform Rregullores së Kuvendit, një iniciativë parlamentare që në fokus ka nevojën ose lejimin nga Kuvendi të një hetimi të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura mbi çështjen e CEZ Shpërndarje sh.a.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Fillimisht, ashtu siç e kërkon Rregullorja dhe normaliteti i punës, nismëtarët do të paraqesin iniciativën e tyre në komision. Besoj se një nga nismëtarët e projektligjit do të marrë fjalën, për ta prezantuar atë para komisionit.

Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – 2 muaj më parë, më 28.9.2015 një grup deputetësh i PD-së ka propozuar për shqyrtim dhe për miratim projektligjin “Për lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura mbi çështjen “CEZ Shpërndarje sh.a.-së”, duke kërkuar që ky projektligj të shqyrtohej me procedurë të përshpejtuar. Debati lidhur me këtë çështje është zhvilluar në Konferencën e Kryetarëve dhe më pas, në seancë plenare. Mbas debateve të gjata me orë të tëra, është votuar lidhur me procedurën e përshpejtuar dhe maxhoranca vendosi se meqë ky projektligj ishte me shumicë të cilësuar, pra me 84 vota, ai nuk mund të kalonte me procedurë të përshpejtuar, por do të kalonte me procedurë të zakonshme, e cila parashikon afatin maksimal 2 muaj dhe sot jemi në afatin maksimal të tij (pa një javë).

Cilat janë arsyet që opozita kërkon një hetim të pavarur ndërkombëtar për këtë çështje?

Arsyet që opozita kërkon një hetim të pavarur ndërkombëtar të kësaj çështjeje për dy afera:

Afera e parë ka të bëjë me marrëveshjen “Për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, sh.a.”, të miratuar me ligjin nr. 114/2014, datë 31.07.2014, që i kanë shkaktuar shtetit shqiptar miliona euro dëm ekonomik, të cilat përbëjnë vepër penale dhe që kanë nevojë për një hetim të plotë dhe të thelluar, për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore autorët e kësaj vjedhjeje të rëndë që i është bërë çdo shqiptari në shifrën prej 700 milionë eurosh, e verifikuar më pas edhe nga institucionet e tjera si KLSH-ja, me një vlerë dëmi të përafërt me të.

Ajo që ka ndodhur dhe që të gjithë shqiptarët e mbajnë mend, përshkruhet gjerësisht në relacionin që kolegët e kanë bashkëngjitur projektligjit.

Pse për ne, zgjidhja e marrëveshjes mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ sh.a. në vitin 2013, përbën një aferë të madhe për të cilën duhet patjetër të kemi një hetim ndërkombëtar, pasi në të janë përfshirë Kryeministri dhe ministrat.

Siç dihet në nëntor të vitit 2012 pati një dështim të negociatave me CEZ sh.a.-në dhe një studio ligjore ndërkombëtare e këshilloi Qeverinë Shqiptare që t'i hiqte licencën CEZ-it dhe në vijim të angazhohej fuqishëm për ngritjen e padive dhe kallëzimeve penale. Konkretisht, sipas studios ligjore të qeverisë së vitit 2012, CEZ-i duhet të mbante përgjegjësi për:

a) Dëme të rrjedhura nga mosrealizimi i masës së investimeve të nevojshme

për përmbushjen e detyrimeve të CEZ sh.a.-së, sipas kontratës për shitblerjen e kuotave dhe abuzimi me pasuritë e CEZ- Shpërndarjes, të vlerësuara përafërsisht në masën 700 milionë euro; (qëndrimi i studios ligjore të përzgjedhur nga qeveria në vitin 2012).

b) Dëme të rrjedhura nga shkëputja e pajustificuar e energjisë elektrike më 16 nëntor 2012 dhe në raste të tjera (e mbani mend të gjithë si u shkëput energjia në ujësjellësa etj);

c) Likuidimi i faturave ndaj KESH-it dhe OST-së, në masën rreth 300 milion euro.

Përveç, padive civile, studio ligjore ndërkombëtare e këshillonte qeverinë të

ngrinte kallëzim penal ndaj stafit ekzekutiv të CEZ-it, si dhe përgatiti një plan masash, të cilat duhet të ekzekutoheshin nga ana e institucioneve të shtetit shqiptar. Ky kallëzim është depozituar në Avokaturën e Shtetit me nr. 526/34 prot., në datën 24.07.2013 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Më 5 mars 2013 CEZ kërkoi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

Më 19 prill 2013 studio ligjore ndërkombëtare e qeverisë, i ka paraqitur me shkrim autoriteteve shqiptare, avantazhet dhe disavantazhet e zgjidhjes me ndërmjetësim, duke vlerësuar se në kushtet kur ende nuk janë mbledhur provat, nuk mund të vijohet me vlerësimin e plotë të dëmit ekonomik dhe juridik të situatës, për të evidentuar mundësitë e zgjidhjes me ndërmjetësim.

Më 28 gusht 2013 është nënshkruar kontrata me BDO-në dhe me pas me “Becker”, që do të përfundonte në 8 javë vlerësimin teknik të CEZ sh.a.-së.

Më 30 shtator 2013 avokati i qeverisë shprehu shqetësimin e madh për cenimin e interesave ekonomike të Republikës së Shqipërisë në rast se nuk ndërmerren në mënyrë urgjente disa masa të caktuara.

Në shkurt 2014 janë përgatitur raportet e eksperteve (vlerësimet teknike, financiare dhe vlerësimi i padive kundër CEZ sh.a. dhe nga CEZ sh.a.), por rezultatet janë mbajtur të fshehura (sipas nesh) nga Qeveria dhe raportet nuk janë zhvilluar me tej sipas porosive të lëna nga ekspertët, në mënyrë që të finalizoheshin, referuar termave të kontratës me ta. Dy raportet e vlerësimit teknik dhe financiar, të cilat ishin vënë në dispozicion të Qeverisë më 10 shkurt 2014, parashikonin shprehimisht se:

(i) CEZ sh.a. nuk investoi në kompaninë e shpërndarjes, referuar marrëveshjes (faqe. 67-74, Vlerësimi i padive nga BDO);

(ii) Kompania u shkatërrua me qëllim nga CEZ -i, e cila kishte një vit që përgatitej të largohej;

(iii) Paratë e marra me kredi nuk ishin përdorur për të bërë investimet në asetet e kompanisë;

(IV) CEZ kishte dështuar për të reduktuar borxhin e keq;

(v) Pjesa takuese e shtetit shqiptar (24 %), kishte shkuar në zero (raporti i BDO –së e më pas i evidentuar nga KLSH-ja);

(vi) E gjithë vlera e kompanisë kishte shkuar në zero (f.80-100 BDO);

(vii) Paratë e mbledhura nuk ishin investuar por në kundërshtim me ligjin ishin transferuar në parajsat fiskale nga kompanitë fantazma të kontraktuara nga CEZ-i (f. 92-97 i raportit BDO);

(viii) CEZ sh.a. kishte dështuar të investonte, të ulte humbjen në rrjet dhe të ulte borxhin e keq, i cili rezultonte i rritur nga 8 milionë në vitin 2007, në 53 milionë në janar të vitit 2013;

(ix) CEZ- Shpërndarje në kundërshtim me ligjin kishte transferuar para te CEZ sh.a. në mënyrë preferenciale karshi kreditorëve të tjerë;

(x) Heqja e licencës nga ERE ishte e drejtë;

(xi) Faturat e papaguara nga CEZ ndaj KESH-it dhe OST-së vijonin në vlerën 3,6 miliardë lekë (f. 102-106 të raportit të BDO);

(xii) Paditë e paraqitura nga CEZ sh.a. janë të mbivendosura dhe nuk janë të llogaritura drejt (f.132 BDO);

(xiii) Paditë në lidhje me taksat, të cilat janë humbur në gjykatat e brendshme në 3,9 miliardë lekë (f.125 të raportit BDO-së).

Pavarësisht detyrimit që kompania CEZ sh.a. i detyrohej shtetit shqiptar në minimumin e saj, kapte vlerën 1 miliardë euro (sipas raportit të kompanive financiare, jo sipas nesh). 500 milionë dollarë CEZ sh.a. i detyrohej vetëm KESH-it dhe OST-së, megjithatë Qeveria deklaroi se kishte arritur të zgjidhte me mirëkuptim mosmarrëveshjen, duke i falur të gjitha detyrimet dhe duke i dhënë CEZ-it 95 milionë euro. Por kjo marrëveshje arrihet në një situatë kur CEZ sh.a. pretendonte 200 milionë euro në arbitrazh investimesh, ndërkohë që kjo kompani kishte ekspozuar karshi shtetit shqiptar një padi në Arbitrazh nga 1-3 milionë euro.

Është e qartë dhe e provuar se nga zgjidhja me mirëkuptim e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, a. s., pa marrë asnjë avokat apo ekspert ligjor ndërkombëtar, i janë shkaktuar shtetit shqiptar miliona euro dëm ekonomik, të cilat, sipas nesh, përbëjnë një vepër penale dhe kanë nevojë për një hetim të plotë dhe të thelluar, për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore autorët e kësaj vjedhjeje të rëndë që i është bërë çdo shqiptari.

Kjo ishte sa i përket aferës së parë.

Lidhur me aferën e dytë, në kohën kur është hartuar nisma nga Grupi Parlamentar i PD-së, në vitin 2015 janë bërë publike në medie disa fakte lidhur me një aferë tjetër korruptive, e cila ka lidhje me kompaninë “DIA”, sipas të cilave avokatët e qeverisë së vitit 2015, kanë deponuar në arbitrazh se ka pasur ndërhyrje nga kreu aktual i Parlamentit, zoti Ilir Meta, i cili akuzohet se ka marrë ryshfet nga "Clifford Chance" pretendon se Kryetari i Kuvendit ka qene një nga përfituesit e pagesave prej miliona eurosh, të përfituara nga kompania e mbledhjes së borxheve prej CEZ-Shpërndarje gjatë viteve 2010 dhe 2011.

Sipas dokumentit të protokolluar nga avokatët e qeverisë në gjykatën e arbitrazhit më 30 qershor 2015, DIA ka përfituar në total 4.5 milionë euro nga CEZ

Shpërndarje, gjatë një periudhe gati 1-vjeçare nga nëntori 2010 deri në tetor 2011. Këto para u paguan nga CEZ-Shpërndarje për një raport të pavlerë për identifikimin e debitorëve, si dhe si një parapagesë për kostot operative të DIA-s për mbledhjen e borxhit. Sipas raportit të avokatit ndërkombëtar të Qeverisë “Rama”, brenda transfertave të lekëve që DIA mori nga CEZ-Shpërndarje, ishin politikanë të rëndësishëm shqiptarë, përfshirë edhe një ish-kryeministër, i proceduar për korrupsion. Kjo është deklarata e avokatit të qeverisë, e shkruar e zeza mbi të bardhë.

Për vetë kompleksitetin që kanë këto dy çështje, si dhe për faktin se në këtë aferë janë përfshirë zyrtarët më të lartë të shtetit, vlerësojmë se një hetim i pavarur nga ekspertë

ndërkombëtarë të organeve ligj-zbatuese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo vendeve të Bashkimit European, do të garantonte besueshmëri tek opinionimi publik, se hetimi është i plotë dhe i gjithanshëm dhe do të hidhte dritë mbi këto 2 çështje.

Cila do të jetë metodologjia dhe procedura që parashikojmë ne? Procedura që parashikojmë ne, është kryer edhe më parë nga ky komision dhe nga Kuvendi, sipas së cilës një trupë e përzgjedhur nga prokurori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do t'i atashohet Prokurorisë së Përgjithshme dhe ajo ka të drejtë të bëjë hetime, lidhur me këto 2 çështje apo lidhur edhe me çdo çështje tjetër. Këta prokurorë kanë të drejtë të bëjnë hetime dhe investigime, por çdo veprim i tyre duhet të koordinohet me prokurorin e Përgjithshëm. Do të jetë prokurori i Përgjithshëm dhe organet e tjera, si gjykatat, që do të vlerësojnë, nëse do të jetë e nevojshme për të marrë masa të ndryshme dhe për të kryer veprime të ndryshme procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, siç janë kontrollet, marrja në pyetje e me radhë. Për të gjitha këto do të jenë organet ligj-zbatuese shqiptare, si gjykatat apo organet policore, ashtu siç parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.

E gjithë veprimtaria e hetuesve dhe prokurorëve do të jetë konform Kodit të Procedurës Penale, Kushtetutës së RSH-së dhe në rast se do të vendoset për ngritjen e ndonjë akuze, sigurisht, ngritja e akuzës do të ndjekë të njëjtat procedura që parashikohen në Kushtetutën e Shqipërisë. Prokurori i Përgjithshëm do të koordinojë më pas të gjithë pjesën ndërmjet grupit të hetuesve ndërkombëtarë, me organet ligj-zbatuese të vendit.

Kjo është procedura. Ne jemi të hapur për çdo pyetje dhe për të sqaruar çdo paqartësi, lidhur me procedurën e një hetimi të pavarur ndërkombëtar, lidhur me këtë çështje. Ne e cilësojmë jetike zbardhjen një orë e më parë të të dyja aferave.

Po ashtu, në fund të projektligjit parashikohet anulimi apo shfuqizimi i neneve, të cilat janë parashikuar në marrëveshjen për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, sh.a., të miratuara me ligjin nr. 114/2014, date 31.07.2014, të cilat pengojnë hetimin, ndjekjen penale, gjykimin, apo dënimin, e personave dhe zyrtarëve që gjenden përgjegjës penalisht, pra të gjithë zyrtarët, të cilët janë përfshirë në këtë marrëveshje.

Lidhur me hetimin ndërkombëtar të kësaj çështjeje ka pasur deklarata publike, të cilat kanë mbështetur këtë hetim ndërkombëtar, të ardhura edhe nga Kryetari i Kuvendit, edhe nga kryetari i opozitës, i cili e ka kërkuar me ngulm këtë hetim ndërkombëtar.

Ka pasur një diskutim në seancën plenare të datës, kur e kemi depozituar kërkesën, për zgjerimin e objektit të ligjit, i cili sipas nesh, është fokusuar në dy çështje në kohën e depozitimit edhe nga ana e kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së është shprehur gatishmëria që të zgjerohet objekti i hetimit ndërkombëtar të zgjerohet dhe të shtrihet, sipas kërkesave që mund të vijnë nga të gjitha partitë parlamentare në këtë proces.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Dëgjuam paraqitjen e nismës të bërë nga një prej nismëtarët e kësaj nisme ligjore. Fjalën e kanë relatorët e projektligjit, të cilët janë deputetët: Ulsi Manja dhe Vexhi Muçmataj.

Zoti Muçmataj, keni fjalën!

Vexhi Muçmataj – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji shoqërohet me disa materiale shtesë në të cilat thuhet shprehimisht, se arsyeja pse kërkohet lejimi i një hetimi ndërkombëtar për çështjen e CEZ-it, është ndikimi politik mbi prokurorinë. Pyetja është: A ka konstatime nëse mund të ketë ndikim politik, që është arritur në këtë konkluzion?

Vetë organi i prokurorisë e kundërshton këtë konkluzion dhe thotë se vetë Prokuroria Shqiptare ka legjitimitetin ka integritetin dhe kapacitetet e duhura për të hetuar çdo vepër penale brenda dhe jashtë territorit, në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës penale.

Pyetja e dytë: Ky projektligj nuk është një ligj organik që miratohet me 3/5. Ai do të ishte i tillë në rast se do të propozonte shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, por në fakt nga mënyra, nga forma dhe përmbajtja që është paraqitur, ky është një ligj i zakonshëm që miratohet me shumicë të thjeshtë dhe pyetja ime është: Në kuptimin e Kushtetutës, a mundet që një ligj i thjeshtë të bëjë ndryshime apo shtesa në një ligj organik të cilësuar, që miratohet me 3/5 e votave?

Pyetja e tretë: A do të konsiderohen të vlefshme veprimet hetimore të kryera nga struktura e huaj në kuptim të nenit 128, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet shprehimisht: “Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme, kur nuk respektohen dispozitat, që lidhen me:

b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim;”.

Këto kisha unë tani për tani.

Fatmir Xhafaj – Unë them se ajo që bëri zoti Muçmataj ishte korrekte. Në mos gabo, ai drejtoi 3 pyetje. Të dëgjojmë përgjigjet për këto 3 pyetje dhe më pas, të vazhdojmë. Kush do të përgjigjet për pyetjet e relatorit Muçmataj?

Urdhëroni, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Mund të filloj unë dhe më tej më plotësojnë kolegët.

Fatmir Xhafaj – Duhet të jenë kolegët që janë nismëtarë.

Eduard Halimi – Anëtarët të komisionit.

Fatmir Xhafaj – Jo, duhet të jenë kolegët nismëtarë, që e mbrojnë projektin.

Eduard Halimi – Atë mund ta bëjë edhe kryetari i grupit parlamentar.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Për mua nuk ka problem, por jeni ju ata që e keni bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Eduard Halimi – Bota portokall është. Është më mirë kjo, se ajo që thoni ju, Fatmir.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Absolutisht, unë jam gjithmonë racional.

Lidhur me arsyen se kërkohet një hetim ndërkombëtar është ndikimi politik mbi prokurorinë. Ne këtu, si Vexhiu, që ka më shumë eksperiencë se unë (e vlerësoj për këtë), ashtu edhe unë me eksperiencën time modeste në drejtësi, e dimë shumë mirë që Prokuroria Shqiptare nuk mund të hetojë dot një çështje, ku janë përfshirë zyrtarët më të lartë të saj. Ajo nuk mund dhe nuk arrin ta bëjë dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Peza!

Mbani shënim dhe flisni kur t'ju vijë radha!

Eduard Halimi – Pyetja ishte: A mendoni që mund të ketë ndikime politike? Dhe unë mendoj se kur në një çështje janë të përfshirë drejtpërdrejt, shefi i qeverisë, ministrat e qeverisë, kur parlamenti ia ka lidhur duart Prokurorisë për të bërë hetime për çështjen e zgjidhjes së marrëveshjes, pra kur vetë parlamenti thotë se ndalohet të hetohen akuzat, sigurisht, fuqizimi i këtij ligji dhe marrja e prokurorëve të huaj, besoj se e rrit besueshmërinë, lidhur me zbardhjen një orë e më parë të kësaj afere.

Lidhur me pyetjen e dytë, nëse projektligji është me shumicë të thjeshtë apo me shumicë të cilësuar dhe a mund të ndryshohet, unë jam tërësisht dakord me ato që thotë zoti Muçmataj dhe kam diskutuar për 4-5 orë në parlament, lidhur me këtë çështje, sepse ai ka shumë të drejtë kur

thotë që ligji është me shumicë të thjeshtë. Një ligj të ngjashëm *copy and paste*, unë me cilësinë e ministrit të Drejtësisë në atë kohë, e kam sjellë në këtë komision me shumicë të thjeshtë. Ky ligj bën hetimin *sui generis* me prokurorë të huaj, të atashuar pranë prokurorit të Përgjithshëm për të hetuar çështje, të cilat janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për opinionin publik shqiptar. Ka qenë me shumicë të thjeshtë. Qëndrimi ka qenë ky: opozita i qëndron variantit që është me shumicë të thjeshtë. Ai nuk ndryshon asnjë ligj.

Hetimi do të jetë brenda Kodit të Procedurës Penale, pra nuk ndryshon asnjë nen të këtij kodi. Do të jetë brenda formatit të Kushtetutës, pra nuk do të tentojë të ndryshojë asnjë nen të Kushtetutës dhe si i tillë, duhet të ishte me shumicë të thjeshtë. Kolegët tuaj e rrëzuan, e hodhën në votim pas 5-6 orë diskutimesh dhe sigurisht, ne i nënshtrohemi vendimit të marrë nga shumica e Kuvendit, siç miratohen dhe siç kryhen procedurat.

Pyetja e fundit ishte se çfarë do të ndodhë me hetimet e kryera deri tani nga prokuroria?
(Ndërhyrje pa mikrofon).

Me aktet hetimore?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Vexhi Muçmataj – A do të konsiderohen të vlefshme aktet procedurale, veprimet hetimore të kryera nga struktura e huaj, në kuptim të nenit 128, pika 1 germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet shprehimisht: “Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat, që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim”?

Eduard Halimi – Ky është një ligj, i cili synon të përputhë të gjitha veprimet procedurale nga dita që prokurorët e huaj shkelin në Rinas dhe deri ditën kur ata largohen nga Rinasi. Çdo veprim që duhet të bëjnë prokurorët e huaj nga dita që zbresin në Rinas dhe deri ditën kur ata largohen nga Rinasi, duhet të jetë në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Çdo akt që ata do të prodhojnë, duhet ta bëjnë sipas këtij kodi. Ne këtu kemi parashikuar, si do t’i hartojnë aktet ata, si do të veprojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nëse ka nevojë që ta ndryshojmë, ne jemi shumë të hapur. Nëse ju thoni se duhet ndryshuar, ne mund t’i japim një parashikim tjetër. Në këtë mënyrë ashtu siç e kemi shkruar, edhe me parlamentin e mëparshëm, në mos gaboj me 130 vota (pra edhe me votat tuaja), është emëruar një grup prokurorësh të huaj që kanë ardhur në Shqipëri, kanë hetuar, kanë kryer akte, nën

mbikëqyrjen e prokurorit të Përgjithshëm, dhe aktet e tyre deri më sot nuk e di që të kenë dalë të pavlefshme apo të ketë pasur ndonjë kontestim të vetëm për pavlefshmërinë e tyre, as kur keni qenë ju në opozitë dhe ne në pushtet, as tani që ju jeni në pushtet dhe ne jemi në opozitë.

Vexhi Muçmataj – Një sqarim: në aspektin historik, ashtu siç tha edhe zoti Halimi, në historinë e parlamentarizmit njihet vetëm një rast, rasti i vrasjes së deputetit Azam Hajdari, kur parlamenti është shprehur me një vendim për të asistuar një prokuror i huaj, jo për të kryer veprime. Në asnjë rast nuk ka asnjë firmë të ndonjë prokurori të huaj, në ndonjë akt procedural. Ajo ka qenë një asistencë teknike ligjore për prokurorinë shqiptare. Kjo është e vërteta për këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Eduard Halimi – Ky është një ligj *sui generis*. Në fakt, është rasti i dytë. Edhe herën e parë ka qenë një ligj *sui generis*. Herën e parë kam qenë me cilësinë e ministrit të Drejtësisë për një ligj që lidhej me hetimin e akuzave, të cilat i vinin një njollë Shqipërisë. U ndoq e njëjta procedurë. Prokurorë të huaj, të ardhur në atë kohë (nuk e di si kanë vazhduar më pas procedurat, sepse nuk i përkiste parlamentit, por i përkiste organit hetues), por me të gjitha votat e parlamentit u bë gati paketa e ligjeve, erdhën prokurorët e huaj, të cilët u atashuan pranë prokurorit të Përgjithshëm. Edhe ai rast është po ashtu. Në mos gaboj atëherë, kanë ardhur 3 prokurorë. Janë kryer akte, janë marrë njerëz në pyetje, janë kryer shumë veprime procedurale, bile kanë ardhur 2 palë në atë kohë. Unë kam nxjerrë të gjithë praktikën, që është ndjekur në atë kohë nga arkivat e parlamentit.

Ai nuk është rasti i parë që është bërë me ligj. Rasti i parë që është bërë me ligj, është ai i vitit 2012.

Rasti i dytë që do të bëhet me të gjitha votat e parlamentit të opozitës dhe të maxhorancës, është ky.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ulsi Manja – Zoti kryetar,

Unë kam 3 pyetje:

1. Duke parë projektligjin e shkruar dhe atë që sqaroi zoti Halimi, prezantuesi i këtij projektligji, më vjen natyrshëm një pyetje: Në projektligj flitet për hetim me prokurorë të huaj, kurse zoti Halimi e prezanton sikur kërkohet ndihmë juridike për hetimin e një çështjeje. A po kërkon me këtë projektligj ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale, apo po kërkon hetim

me prokurorë të huaj? Më duket sikur në projektligj flitet ndryshe, ndërsa në prezantim kërkohet diçka tjetër.

2. Në nenin 123 të Kushtetutës sonë lejohet delegimi i kompetencave shtetërore për çështje të caktuara që në rastin konkret, kërkohet delegimi i një kompetence shtetërore që është hetimi penal i një autoriteti të huaj. Kushtetuta e kushtëzon me 2 klauzola: e para, kjo kompetencë shtetërore u delegohet vetëm organizatave ndërkombëtare.

E dyta, kjo bëhet mbi bazën e një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Me këtë projektligj synohet të delegohet një kompetencë shtetërore, që është hetimi penal i një çështjeje të caktuar (çështja e CEZ-it), me një ligj të brendshëm të vetë shtetit tonë.

Pyetja që kam është: pa u hyrë problemeve kushtetuese të thella, që ka ky projektligj në gjykimin tim, por e marrim për një moment se gjithçka është në rregull. Çfarë do të ndodhë në rast se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose ndonjë vend i BE-së, siç përcaktohet në nenin 3/2 të këtij projektligji, nuk do të pranojnë të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me prokurorinë shqiptare për hetimin e kësaj çështjeje. A do të gjejë zbatim ky projektligj? Ti e kërkon, por unë nuk dua.

Pyetja e tretë, duke iu referuar nenit 12 të këtij projektligji, ky projekt krijon një barrë financiare mbi buxhetin e shtetit, pra ka kosto. Sa është kjo faturë? Sepse një projektligj që krijon barrë mbi buxheti e shtetit ose ka kosto në buxhetin e shtetit, duhet të shoqërohet edhe me faturë financiare. Nga hartuesit e këtij projektligji: a ka një faturë financiare që i bashkëngjitet atij?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Cili do të përgjigjet për pyetjet e relatorit, zotit Manja?

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Meqenëse janë çështje teknike, i kemi trajtuar edhe para tre vjetësh, çfarë do të ndodhë? Unë u mundova ta shpjegoja në fillim. Do të ndodhë që do të jenë prokurorë, të cilët do të asistojnë prokurorinë apo do të jetë ndonjë trupë prokurorësh që do të bëjnë hetim të pavarur? Cili është dallimi? Ajo që është thënë e zeza mbi të bardhë është kufizimi në nenin 2: “Organ ligjzbatues i huaj”. Pra, prokurorë të huaj nënkuptojmë një strukturë të specializuar hetimi, që ushtron veprimtarinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe / ose në një vend të BE-së, e cila pranon të caktojë prokurorët e saj në Shqipëri për llogari të hetimit të akuzave të bëra publike për çështjen e CEZ-Shpërndarje. I jep përgjigje edhe pyetjes së dytë që pranon, sepse ai që nuk pranon, nuk pranon. Për pyetjen e dytë Partia Demokratike në dijeninë time ka zhvilluar negociata

edhe me partnerët të cilët janë gati të caktojnë prokurorë të huaj. Çfarë do të bëjnë këta prokurorë të huaj? Çfarë do të ndodhë? Si do të zhvillohet hetimi? Prokurori i Përgjithshëm brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ngarkohet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me SHBA-të apo vendet e BE-së, të njëjtën procedurë që ka ndjekur ish- prokurori i Përgjithshëm në atë kohë në vitin 2012. Shtetet kanë pranuar në atë kohë të caktojnë prokurorë dhe tani do të pranojnë sërish. Uroj të caktojnë prokurorë. Objekti i marrëveshje, është caktimi i prokurorëve të organit ligjzbatues të huaj për të hetuar mbi çështjen e CEZ-it. Strukturat përgjegjëse i ofrojnë organit ligjzbatues të huaj bashkëpunim të plotë dhe të gjithanshëm. Çfarë do të bëjnë këta prokurorë? Do të asistojnë, do të japin leksion apo do të bëjnë hetime?

Neni 5. Grupi i prokurorëve të huaj, organi ligjzbatues i huaj, që e cilësova në grupin e prokurorëve të huaj, ka të drejtë:

a, “ Të dëgjojë dëshmitarë, ekspertë dhe persona të akuzuar në Shqipëri.

b, “ Të marrë prova dhe të mbajë çdo dokument dhe të gjitha materialet që janë të rëndësishme për hetimin, gjykim në përputhje me legjislacionin shqiptar”, pa bërë asnjë ndryshim në legjislacionin

Shqiptar.

c, “Të këqyrë mjedise apo dokumente”.

d 1.Të ndërmarrë çdo veprim procedural dhe veprime të tjera që mund të jenë të nevojshme në realizimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm për përfundimin e hetimit apo për përgatitjen e zhvillimit të ndjekjes penale”.

2. “Nëse nga veprimet dhe aktivitetet hetimore që ndërmerren nga prokurorët e huaj duhet të mbështeten nga një vendim prokurorie apo gjykate”. Ju e dini se cilat janë masat, ato të sigurimit personal apo të tjerat, për kontrollin e banesave dhe me radhë të gjitha të tjerat, nëse duhet të mbështeten nga një veprim prokuroria apo gjykate sipas ligjeve shqiptare, procedohet pa asnjë vonesë në përmbushjen e tyre nga autoritetet shqiptare.

Te përkufizimet jepen se cilat janë autoritetet shqiptare: prokurori i Përgjithshëm dhe të gjitha institucionet e tjera. Ekzekutimi i çdo veprimi që kërkon forcë ose kufizon të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve kryhet në pajtim me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ky nen është *copy-paste* i atij që ky parlament e ka miratuar me 100% të votave, në mos gaboj.

Cila është kostoja financiare e këtij ligji? Sot nuk mund ta dimë. Partnerët tanë mund ta paguajnë vetë pjesën e prokurorëve, si në rastin e hetimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, ta mbaroj!

Për pjesën e financave nuk përgjigjem dot, por në rastin e hetimit të çështjes, për shembull të Azem Hajdarit që përmendni zoti Muçmataj, sipas dokumenteve parlamentare që kemi parë dhe praktikës parlamentare ka pasur një kosto financiare, e cila është paguar nga qeveria shqiptare për pagimin e këtyre prokurorëve.

Në rastin tjetër që ju tregova, për hetimin e akuzave të Dick Martit që ka pasur prokurorë të huaj, qeveria shqiptare nuk ka paguar asnjë kosto, pra nuk ka pasur asnjë kosto financiare në implementimin e zbatimit të atij ligji. Kjo është një çështje që mbetet për t'u parë. Ne kemi parashikuar që qeveria shqiptare të marrë përsipër të gjitha kostot që mund të lindin eventualisht. A do të jenë kosto të papërbalueshme? Është i pakrahasueshëm hetimi i akuzës, hetimi i aferës së CEZ-it me 700 milionë euro dhe zbardhja e saj në krahasim me të gjitha kostot e tilla edhe nëse duhet të paguani, të paktën nga precedentët e mëparshëm të këtij parlamenti apo dhe në rastet e tjera janë shumë minimaliste.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Meqenëse jemi relatorë, të qartësojmë vetveten. Me sa kuptova unë, zoti Halimi thotë se prokurorët e huaj do të kryejnë të gjitha veprimet procedurale hetimore, por firmat do t'i nxjerrin prokurorët shqiptarë tek aktet, nëse e kuptova mirë.

Zoti Halimi, nëse është kështu i bie që Shqipëria e ka nënshkruar Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në fushën penale. Prokurorinë shqiptare nuk e pengon asnjë lloj ligji të kërkojë këtë ndihmë me prokurorë në SHBA apo nga vendet e BE-së, nëse është kështu. Në projektligj kërkohet që autoritetet e huaja, në rastin konkret prokurorët e huaj të marrin përsipër hetimet e një çështjeje penale konkrete në territorin e shtetit shqiptar.

Më shqip, a do të firmosë ky prokuror i huaj në një kontroll banese? Do të firmosë ai në një sekuestrim të pronës? Do të firmosë ai në një kërkesë drejtuar gjykatës shqiptare për masë sigurimi? Pra, që të jemi konkretë.

Fatmir Xhafaj- Faleminderit!

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi - Të gjitha këto çështje i kemi trajtuar gjerësisht kur kemi bërë ligjin e mëparshëm. Po ju përgjigjem:

E para, ndihma e ndërsjellë juridike është tjetër gjë. Ndhma e ndërsjellë juridike është kur unë kërkoj që ta bësh ti hetimin në Itali për një rast që kam dijeni. I kërkoj prokurorëve italianë të bëjnë hetime në Itali.

Ju keni qenë prokuror dhe e dini më mirë sesa unë, unë e kam të prejdardhur, e kam nga leximi i letrave. Pra, ajo është ndihma e ndërsjellë. Unë i kërkoj prokurorit italian të bëjë disa hetime atje për llogari të çështjes sime. Nuk është ky rasti. Rasti është që prokurorët italianë, amerikanë apo të vendeve të tjera të vijnë këtu dhe të bëjnë hetime. Raste të ngjashme kemi pasur për marrëveshjen unike që kemi bërë me Italinë. Kemi marrëveshje ndërkombëtare të nënshkuara me Italinë, diku nga vitit 2010, implementuar në vitin 2012 ku bëhen hetime të përbashkëta: prokurorë italianë dhe prokurorë shqiptarë për të hetuar. Çfarë kemi këtu? Ajo që kemi është e përcaktuar në nenin 5.

Kur të kalojmë në diskutimin nën për nen e shikojmë përsëri. Unë po e përsëris: grupi i prokurorëve të huaj këtu është nën ombrellën e prokurorit të Përgjithshëm. Prokurorët e huaj kanë të drejtë vetëm të bëjnë këto veprime. Këtu nuk bëhet fjalë as për sekuestime, as për kontroll të banesës, as për arrestime dhe as për përgjime. Nuk i bëjnë dot prokurorët e huaj, por këta të fundit duhet t'i kërkojnë sipas këtij modeli, ky model nuk është shpikje shqiptare, të jemi të qartë, nuk është se në vitin 2012 u ngritëm në mëngjes dhe na shkoi në mendje për të shpikur një model për hetimin ndërkombëtar, por është një model, i cili është marrë me mbështetjen e partnerëve, është marrë nga praktikat e vendeve të tjera. Prokurorët ndërkombëtarë do t'u kërkojnë autoriteteve shqiptare, që në këtë rast do të jetë prokurori i Përgjithshëm për të bërë kontroll të një banese, për shembull. Do të jenë autoritetet, ajo që cilësove, nëse veprimet dhe aktivitetet hetimore që ndërmerren nga organet e huaja, nga prokurorët e huaj duhet të mbështeten nga një vendim i prokurorisë apo i gjykatës, janë këto që cituat ju, pra një vendim prokurorie që ka të bëjë me urdhër ndalimin, me kontrollin e banesës, me përgjimet dhe me radhë, këto janë apo jo? Ju jeni prokuror dhe e dini vetë. Në këtë rast do të procedohet pa asnjë vonesë për përmbushjen e tyre nga autoritete shqiptare. Pra, do të jenë autoritetet shqiptare, ata do t'i bëjnë kërkesë prokurorit të Përgjithshëm, ky i fundit me këtë ligj është i detyruar t'u japë rrugë të gjitha kërkesave, kur ato nuk bien ndesh me Kushtetutën, se ne nuk ndryshojmë Kushtetutën dhe më pas autoritetet, prokuroria apo gjykata do të kryejnë veprimet e caktuara.

Cila është e rëndësishme në gjithë këtë proces? Prokurorët e huaj do të bëjnë hetimin, ndjekjen penale, ndërsa gjykimin do ta bëjnë autoritetet shqiptare. Gjyqin nuk e bëjnë prokurorët

e huaj, hetimin, zbardhjen e të gjithë aferës, nëse është aferë, sepse edhe mund të mos jetë aferë, pasi mund të mblidhen prokurorët e huaj, mund të bëjnë hetime dhe të thonë se nuk është aferë. Hetimi që të ketë besueshmëri duhet të bëhet nga prokurorët e huaj, pastaj do të jenë autoritetet shqiptare që do të marrin shqyrtimin përkatës. Nuk duhet të shkojë në Hagë.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Peza.

Dashamir Peza - Unë kam një pyetje. Më habit kjo situatë. Për çështjen e një granti, nëse duhet të kalojë në parlament ose jo, duhet të shkojmë në Gjykatën Kushtetuese, kurse për të marrë prokurorë të huaj që të hetojnë në emër të autoriteteve shqiptare çështje të caktuara nuk paska asnjë dilemë. A është e mundur kjo, apo po dëgjoj diçka gabim sot?

Fatmir Xhafaj- Faleminderit!

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Po e trajtojmë si një çështje teknike. Unë jam dakord, sepse brenda fushës jam unë, nuk lodhem.

Fatmir Xhafaj – Edhe ata dy prokurorët brenda fushës janë.

Eduard Halimi – Unë e thashë që janë më ekspertë se unë në çështjet penale, unë nuk jam ekspert i saj fushe.

Po i përgjigjem zotit Peza.

Fatmir Xhafaj - Zoti Peza nuk ka qenë prokuror.

Eduard Halimi - Dilema është një: do t'i hetojmë këto afere? Kemi vullnetin politik për t'i hetuar nga një institucion i pavarur këto afere? Këtë debat ne e kemi bërë para një viti, në vitin 2014. Ne thoshim, mos e bëni këtë marrëveshje, se kjo që po bëni është aferë, ka këtë, ka atë, ka këto probleme, por juve e bëtë, e miratuat në parlament. Madje miratuat edhe ligjin që nuk lejohet të hetohen më, sepse këta duhet të kenë amnisti. E parashikuat në marrëveshje. E diskutuam në parlament dhe me radhë, tani vijmë në këtë moment. Unë shikoj se ka një vullnet të të gjithë kryetarëve të partive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Më falni!

Zoti Halimi, do ta ndërpres nëse do të vazhdojmë kështu. Secili të bëjë pyetjet dhe të dëgjojmë përgjigjet.

Zoti Halimi fokusohuni te pyetja!

Eduard Halimi – Dilema është do ta hetojmë këtë aferë apo do ta mbulojmë, do ta lëmë të flerë? Ne si opozitë kërkojmë ta hetojmë me prokurorë të pavarur. Të jemi të sinqertë, nuk i kemi votat, nuk e bëjmë dot. Sot nuk e bëjmë dot. Kjo është evidente, por ka një gatishmëri të shprehur nga kryetari yt, nga kryetari im, nga kryetari i partisë tjetër parlamentare, pothuajse i gjithë spektri, që jemi për një hetim ndërkombëtar. Ky është drafti që kemi sjellë. Doni të bëjmë ndryshime në këtë draft? Dakord, kur të futemi nën për nën, të bëjmë ndryshime. Të gjithë kryetarët tanë politikë, sepse nën ombrellën e partive politike jemi, shprehen se do të bëjmë një hetim ndërkombëtar të pavarur. Unë nuk kam fare dilemë në këtë gjë. Të bëjmë ndryshimet, futemi nën për nën dhe të ecim.

Dashamir Peza - Zoti kryetar, kam bërë një pyetje nga e cila...

Fatmir Xhafaj - Ju lutem!

Një sekondë!

E para këtë mbledhje e drejtoj unë. Ashtu siç ju respektoj unë një e nga një, duhet të më respektoni edhe ju në këtë detyrë që jam.

Ju keni të drejtën e pyetjes, ai ka të drejtën e përgjigjes si ta mendojë ai. Edhe unë po prisja t'i kthente përgjigje pyetjes suaj. Ai e çmoi të fliste për kryetarët dhe jo për pyetjen tuaj. Pyetja juaj, ashtu si e kuptova unë është: kjo është një çështje kushtetuese, a ka vend për një rishikim kushtetues?

Zoti Halimi tha se e kanë gjykuar kryetarët e partive këtë gjë.

Eduard Halimi - Një minutë!

Nuk do të guxoja të nënshkruaja një draft, i cili mund të kishte implikime kushtetuese. Unë nuk do ta bëja këtë gjë. Jam i bindur se nuk ka asnjë implikim kushtetues. Jo vetëm unë, por një pjesë e mirë e të gjithëve që janë këtu nga Pandi, dhe të gjithë të tjerë kanë firmosur dhe kanë votuar këtë draft në vitin 2012 me të gjitha parashikimet. Ka pasur edhe atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Mund të ndajmë pikëpamje të ndryshme dhe do t'i themi kur të vijë radha, nëse kemi pikëpamje të ndryshme.

Eduard Halimi - Ka pasur këto parashikime, këto implikime në legjislacionin vendas, janë zgjidhur konfliktet dhe nuk ka prodhuar asnjë implikim kushtetues zbatimi i ligjit me hetim të prokurorëve të pavarur.

Hajdeni edhe ta ndryshojmë nëse ka implikim! Për ne nuk ka asnjë implikim kushtetues dhe as të ndonjë ligji me shumicë të cilësuar, siç e diskutova më parë edhe me zotin Muçmataj, që ngriti me të drejtë shqetësimin e tij.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë kam pyetje edhe për iniciatorët, edhe për relatorët. Duke qenë se dy do të jenë faktorët kryesorë mbi të cilët do ta mbështesë në parim veprimin projektligji i propozuar: prokurori i Përgjithshëm dhe organet ligjzbatuese të huaja. Ne i kërkojmë prokurorit të Përgjithshëm brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me këto organe ligjzbatuese.

Pyetja e parë, cili është opinionioni i Prokurorisë së Përgjithshme për këtë projektligj?

Pyetja e dytë, dëgjova nga përfaqësuesit e opozitës se Partia Demokratike ka komunikuar me partnerët e huaj lidhur me mënyrën sesi do të zbatohet ky ligj. Besoj e kanë pasur fjalën për organet ligjzbatuese të shteteve të huaja. A mund të kemi një transparencë pak më të gjerë lidhur me këtë fakt?

Pyetja ime është, a është pranuar nga organet ligjzbatuese në parim nga ky komunikim i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe/ ose të vendeve të BE-së ky bashkëpunim për këtë lloj hetimi?

Fatmir Xhafaj – Cili do të flasë nga kolegët opozitarë?

Eduard Halimi – Diskutimi në këtë fazë të Komisionit të Ligjeve është në parim, nëse jemi pro apo kundër hetimit të pavarur. Unë çmoj të mbyllim diskutimin në parim, pastaj kur të shkojmë nen për nen do të përgjigjemi për çdo formulim që është bërë dhe të bëjmë ndryshimet. Të shprehen të gjitha grupet apo të gjithë deputetët lidhur me çështjen në parim, nëse janë apo jo për hetimin ndërkombëtar me prokurorë të huaj.

Lidhur me opinionin e prokurorit të Përgjithshëm, nuk e dimë. Partia Demokratike, nuk ka komunikim dhe nuk e dimë se cili është opinionioni i prokurorit të Përgjithshëm për këtë çështje.

Lidhur me komunikimet me partnerët e huaj për këtë çështje, ka komunikime të vazhdueshme me partnerët për hetimin e kësaj afere dhe aferave të tjera të cilat janë attribute të opozitës dhe shpresoj që në momentin e duhur kur të miratohet ligji, nëse e çmoni se duhet të merret ndonjë mendim, ju mund ta çmoni. Ne gjucojmë se ky projektligj me këtë formë siç është duke i dhënë attribute prokurorit të Përgjithshëm të lidhë marrëveshje me autoritetet dhe me

partnerët e huaj të bëjë hetimin e pavarur të kësaj çështjeje. Ky është qëndrimi dhe informacioni që mund t'ju jap sot.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Meqenëse mu drejtuat, përderisa ju morët një iniciativë të tillë, do të ishte korrekte të kishit bërë një proces konsultimi para se ta sillnit këtu projektin. Dakord, e bëjmë ne.

Që të jemi korrektë, unë i jam drejtuar institucioneve. Do të pres përgjigjet e tyre.

Eduard Halimi - Ka shtatë javë që ligji mbahet këtu. Duhet ta kishim bërë para tre javësh.

Fatmir Xhafaj – Është ligj që duhet reflektuar. Ju jeni lodhur shumë, keni marrë ligjin e para katër vjetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi votuar ne, por do t'jua them se çfarë kemi votuar ne dhe çfarë jemi duke votuar. Jemi të dy juristë dhe e dimë shumë mirë se cili është objekti i njërit dhe cili është i tjetrit. Këtu i thonë: “Hapu ti, të vij unë”, kurse atje ishte ai në punën e tij. Nuk është ky debati. E lëmë këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Muçmataj.

Vexhi Muçmataj - Për pyetjen e zotit Majko unë e thashë edhe në pyetjen e parë, prokuroria shqiptare është prononcuar: “E kemi legjitimitetin, integritetin dhe kapacitetin e duhur për të hetuar veprat penale, qoftë brenda territorit, qoftë jashtë tij”.

Për sqarim të kolegëve deputetë opozitarë, ne nuk kemi asgjë me ligjin “Për lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar”. Ne bëjmë disa pyetje për të sqaruar kontekstin ligjor me qëllim që së bashku të gjemë zgjidhjen e duhur që të mos kemi kontestime brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor. Ne nuk kemi asnjë paragjykim, por çështja është që të dalë një gjë e pjekur, që nuk kontestohet nesër, nuk bie ndesh me Kushtetutën dhe me ligjet e tjera të vendit.

Fatmir Xhafaj- Po zoti Manja.

Ulsi Manja – Zoti kryetar, unë në cilësinë e bashkërelatorit me kolegun Muçmataj, do t'i kërkoja komisionit shtyrjen e diskutimeve në parim të këtij projektligji me qëllim që pyetjet, të cilat u bënë nga kolegët, nga ne si relatorë, që ishin në funksion të qartësimit të pozicionit tonë ligjor, me qëllim që të hartojmë një raport para diskutimit në parim, një relacion të qartë për kolegët deputetë në këtë komision...

Sepse kjo është një çështje e karakterit kushtetues, ligjor dhe teknik. Ne kemi nevojë për pak kohë, qoftë edhe ditën e premtë, të kemi mundësinë të vijnë edhe përgjigjet e disa

institucioneve që u kemi kërkuar mendim, me qëllim që të hartojmë një raport para se të hapet diskutimi në parim. Për dy-tre ditë bëhemi gati.

Fatmir Xhafaj – Kur të vijmë përgjigjet.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar në lidhje me propozimin që bëhet për shtyrjen e diskutimit, dua të them se u bënë kaq javë që ky projektligj është këtu, po kështu të gjitha shkresat që ishin të nevojshme për t'u nisur, mund të ishin nisur me kohë.

Fatmir Xhafaj - Po, janë nisur.

Oerd Bylykbashi - Nuk mundet që një ligj që kemi kërkuar, i cili përbën një çështje shumë të madhe, të rëndësishme për opinionin publik, që njerëzit të persin dhe çdo vonesë nuk tregon asgjë të mirë. Ne kemi mundësinë të fillojmë diskutimin në parim dhe t'i japim zgjidhje të gjitha çështjeve.

Unë dëgjova relatorin, zotin Muçmataj që tha se në parim nuk kemi gjë kundër, por diskutojmë që të qartësohemi, ta shikojmë te diskutimi nen për nen, por çdo lloj tentative për ta shtyrë ose çdo lloj ideje për ta shtyrë që të marrim kohë, të sqarohemi e të tjera është diçka që nuk flet mirë për qëllimin politik. Ne duhet të fillojmë tani pa vonesë. Ne kërkuam që ky ligj të futej me procedurë të përsheptuar. Ju vendosët të mos jetë kështu, bëtë interpretimin dhe thatë se është një ligj me shumicë të cilësuar, ndërsa sot thoni se është një ligj me shumicë të thjeshtë. Nuk e keni ndarë ende këtë pjesë. Është e qartë se është pjesë e një taktike. Qëllimi është shumë i thjeshtë. Diskutimi është shumë i thjeshtë, duam apo nuk duam për një hetim të pavarur nga kapja politike, nga influencat politike, të gjithanshëm dhe të plotë. Kaq e thjeshtë është. Ne jemi komisioni kompetent dhe kemi të gjithë bagazhin e nevojshëm për ta bërë diskutimin këtu dhe sot, pa u zgjatur më tej. Propozimet për shtyrje, për të marrë kohë, nuk do të shtojnë asnjë gjë në lidhje me atë që mund të diskutojmë, por vetëm përpiqen të agravanojnë këtë lloj situatë.

Fatmir Xhafaj - Dua të bëj dy sqarime: është e vërtetë që është mbajtur qëndrimi që ky është një ligj, që nëse votohet duhet të votohet me shumicë të cilësuar.

Ajo që tha zoti Muçmataj është që kjo, ajo të cilën keni paraqitur ju është për një shumicë të thjeshtë në sensin e normës që krijon. Nëse do të krijojmë një normë të re procedurale duhet t'i japim fuqinë e Kodit të Procedurës Penale. Kjo ishte logjika. Nëse do t'i japim fuqi, do t'i japim fuqinë e Kodit të Procedurës Penale, që do të thotë që kërkon një votim si për Kodin e Procedurës Penale. Arsyetimi që bëri relatori, siç e kuptova unë është që kjo, të cilën e keni sjellë këtu, nuk ka vlerën e një norme procedurale. Këtë e tha ai, se çfarë do të them unë...

Ju lutem!

Mos u nitoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të shkojmë te substanca. Ky është një ligj i rëndësishëm, sepse ka implikime kushtetuese, thonë relatorët. Kështu mendoj edhe unë.

Së dyti, flitet për një raport të rëndësishëm që ka të bëjë me sistemin aktual të drejtësisë penale dhe për një praktikë të re apo të çelur thoni ju, të cilën duhet ta konsolidojmë më tej.

Së treti, flitet për një çështje, që është e vërtetë që ndajmë qëndrime të ndryshme, opinionin publik dhe ne lidhur me mënyrën sesi e trajtojmë atë. Këto nuk janë çështje që do të kalojnë thjesht me një diskutim. Ajo që ndodhi këtu ishte kjo: ju dhatë një shpjegim se do të paraqitni këtë iniciativë dhe nuk është hera e parë. Po të ishte sot qeveria, do të vinte këtu, do të paraqiste iniciativën, do t'i bënim disa pyetje dhe do t'i thoshin: dakord, ju dëgjuam ju, na lini të reflektojmë. Ajo që thanë kolegët është: ju dhatë këto përgjigje? Po. Ne kemi këto çështje për të ngritur. Ai thotë: na jepni kohë për dy gjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si gjithmonë. Prandaj të jesh njeri i ditur, nuk ka ndonjë gjë të keqe. Ne të respektojmë.

Ju lutem! Kur ju pyetët dhe u përgjigjet unë nuk ju ndërpreva.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju falënderoj shumë për ndihmën tuaj në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, por tani të mbetemi brenda për brenda komisionit. Çështja shtrohet, se ne dëgjuam përgjigjet tuaja, ndërkohë me iniciativën si kryetar i komisionit, siç kam bërë dhe kam detyrën ta bëj për çdo ligj tjetër, kam bërë dhe kam nisur disa kërkesa, për institucionet përkatëse ku u kam thënë të japin opinionin e tyre për çdo projektligj në këtë parlament. Nuk kemi pse të bëjmë përjashtim te ky projekt, besoj apo jo?

Për këtë po presim përgjigjet, të reflektojnë relatorët dhe këtu e mbyllim këtë diskutim për sot për të vazhduar sapo relatorët të jenë gati.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E mbylla tani.

Gent Strazimiri - Ti mund të ikësh me vrap nga kjo mbledhje, por kjo nuk të shpëton. Ti duhet të presësh një përgjigje nga gjëja.

Fatmir Xhafaj – Keni ditë tjetër dhe do të diskutoni.

Gent Strazimiri – Sot është dita. Ka shtatë javë që ligji pret të jetë sot gjëja. Ti mund të ikësh, të gjithë mund të ikni nga salla dhe të thoni: mbledhja u mbyll...

Fatmir Xhafaj – Po të ishte për ta mbyllur e kishim mbyllur sot me një fjali.

Gent Strazimiri - Keni marrë urdhër të mos e mbyllni me një fjali. Keni marrë urdhrin të mendoheni dhe të kërkonti kohë. Ti sapo the disa gjëra. Nuk është korrekte edhe për opinionin publik që na ndjek, edhe për të gjithë që jemi këtu. Thatë disa gjëra, u përpoqe të bësh një përmbledhje, nuk bërë një përmbledhje, por deformove gjërat. Deformove kur the se është normë procedurale dhe duke qenë se ka fuqinë e Kodit të Procedurës Penale, duhet të jetë me shumicë të cilësuar e të tjera me radhë, në këtë parlament ka ndodhur që strukturave të tjera të këtij shteti u janë dhënë kompetenca të Kodit të Procedurës Penale, të Policisë Gjyqësore dhe nuk kemi përdorur votim të cilësuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord, kur të vijë radha për diskutim, thuaj këto gjëra.

Gent Strazimiri – Kur Presidentit të Republikës, Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, këtu kemi qenë dhe keni thënë, nuk ka nevojë ta pyesim dhe të marrim mendim.

Fatmir Xhafaj - E mbyllim mbledhjen këtu.

Nesër kemi ligjin “Për pronat”.

Gent Strazimiri - Ikni fshehurazi, si ilegalët.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

MBLEDHJA MBYLLET